



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI
"ISMAIL QEMALI" VLORE

Nr. 244 Prot
Vlorë më 17.01.2025



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E METROLOGJISË

Nr. 233 Prot
Tiranë më 22.01.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

DHE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË

TIRANË

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë Tiranë, më poshtë të quajtura "palë".

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, institucion i arsimit të lartë publik, përfaqësuar nga **Prof. Dr. Aurela SALIAJ**, Rectori i Universitetit.

dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë Tiranë, përfaqësuar nga **Znj. Erinda Piluri**, Drejtor i Përgjithshëm (i komanduar)

Nisur nga interesi i përbashkët palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja")

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 4, gërma c).

Neni 2

Qëllimi dhe mënyra e bashkëpunimit

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë Tiranë, duke përfshirë:

1. Bashkëpunimin e pedagogëve të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë Tiranë, si dhe studentëve për realizimin e detyrave të kursit, projekteve dhe kërkimit shkencor në fushat e Inxhinierive mekanike, navale dhe elektrike;
2. Vënien në dispozicion të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për mësimdhënie në modulet e programeve mësimore të FSHTN;
3. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e);
4. Realizimin e praktikave mësimore dhe profesionale të programeve të fushës së Inxhinierisë dhe Teknologjisë Detare, të ofruara nga FSHTN.

Neni 3

Sfera e bashkëpunimit

1. Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- a) Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti "Ismail Qemali";
 - b) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.
-

2. Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në dy cikle studimi:

- a) Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor;
- b) Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master (profesional dhe shkencor).

3. Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- a) Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara;
- b) Praktikat mësimore;
- c) Praktikat profesionale;
- d) Projektet kërkimore.

Neni 4

Detyrimet e palëve

1. Secila palë e Marrëveshjes do të caktojë një person kontakti për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.
2. Personeli i Shkencave Teknike dhe Natyrore, studentët e programeve mësimore të FSHTN si dhe personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë Tiranë janë të detyruar të zbatojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje, për të cilat është rënë dakort nga titullarët e të dy institucioneve.
3. Amendamente të mundshme ose shtesa të kësaj Marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrihen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.
4. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve.

Neni 5

Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjesh të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive Madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 6

Përdorimi i të dhënave

Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë Tiranë kanë detyrimin në mbrojtjen e të dhënave konform ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe ruajtjen dhe mospërdorimin e informacioneve e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7
Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 8
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet përmes mirëkuptimit dhe negociatave mes Palëve.

Neni 9
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në dy 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit Vlorë dhe Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, 2 (dy) kopje do të depozitohet në Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë Tiranë.

PËR
UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI
VLORE

PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË METROLOGJISË
TIRANË

REKTORE
Prof. Dr. Aurela Saliaj

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
(i komanduar)
Erinda Piluri

